

**Letër e hapur  
Kryetarit të Komunës së Therandës z. Blerim Kuçi**

I nderuari z. Kuçi,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shprehur që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7-12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Për fshatin Budakovë: sigurimin e ujit të pijes, ndërtimin e objektit të zyrës së gjendjes civile, shtëpisë së kulturës dhe çerdhes së fëmijëve;
- Për fshatin Leshan: ndërtimin e rrugës Leshan i Vogël-Shirokë, ndërtimin e objektit të ri shkollorë, rregullimin e rrjetit të ujësjellësit, deponi për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave dhe stimulimin për pesë bujqit më të suksesshëm të Leshanit;
- Për fshatin Stravucinë: rregullimin e ujësjellësit, asfaltimin e rrugëve nëpër fshat, ndërtimin e rrugës së re Stravucinë-Mohlan, urbanizimin e fshatit dhe zgjedhjen e problemit të hekurudhës;
- Për fshatin Nishor: rregullimin e kanalizimit, investime në sigurimin e ujit të pijshëm, rregullimin e rrethojës së shkollës, meremetimin e xhamisë së fshatit;
- Për fshatin Studencan: meremetimin e shkollës, rregullimin e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimin, ndërtimin e infrastrukturës rrugore, dhe investime në mbrojtjen e ambientit;
- Për fshatin Bllacë: ndërtimin e shtëpisë së kulturës, ndriçimin publik, funksionalizimin e rrjetit të ujësjellësit, përkrahjen e 10 familjeve që merren me bujqësi;
- Ndërtimin e rrugës Kroj i Madh-Kravasari dhe rrugës Kroj i Madh-Bellanicë;
- Ndërtimin e rrugëve: Budakovë-Dardhishtë e Epërme, e gjatë 3.5 km;Lagjja e Palushëve-lagjja Hoxha, e gjatë 4.2 km; Lagjja Buzhala-Lagjja Palush, e gjatë 2.8 km;
- Ndërtimin e shtëpisë së kulturës;
- Ndërtimin e çerdhes së fëmijëve;
- Bursa për 100 studentë nga komuna e Suharëkës;
- Më shumë kujdes për banorët e Novosellës së Ulët;
- Përkrahje për ndërmarrjet prodhuese të cilat sjellin zhvillim ekonomik dhe vende të reja puna (prodhuesit s'do të paguajnë taksë );
- Formimin e drejtorisë për diasporë në mënyrë që të afrohet diaspora për të investuar në këtë komunë;
- Buxhet më të lartë për shërbimet e shëndetësisë (shërbimi shëndetësor, spitali emergjencës, si dhe shërbimet spitalore shtëpiake), arsimit, sportit, kulturës dhe rinisë;
- Politika të reja buxhetore, që nënkupton uljen e taksave (e njëherazi rritjen e të hyrave);

- Përkrahje për bujqësinë; do të krijohet agjencioni për përkrahje të agrobiznesit, hartim programesh, fizibilitete, bënë kërkesa ne fondet për bujqësi, etj. 120 bujq do të stimulohen nga agjencioni (qoftë përmes granteve apo kredive), do të sigurohen karburantet, farat etj. për një kategori të bujqve – të përcaktuara me kriteret nga agjencioni;
- Sigurimin e ujit të pijshëm, përmes planit strategjik që ka hartuar AAK-ja (ndërtimin e rezervuarëve kryesore, rregullimin dhe ndërtimin e rrjetit kryesor, pompave dhe puseve);
- Rregullimin e rrugës dytësore (për shkarkimin e rrugës kryesore Prishtinë - Prizren, sidomos për automjete e renda, si dhe rrugën Dule - Suharekë - një rrugë dytësore e mbushur me zhavorr);
- Ndërtimin e unazës në vreshtarinë në Biraqen si dhe vendosja e shenjave të komunikacioni;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)